



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI

Nr. 2253 prot.

Shkodër, më 13.07.2023

V E N D I M

Nr. 179, datë 13.07.2023

**“PËR MIRATIMIN PARAPRAK TË NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT
AKADEMIK NË USH”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, dt 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 38, germa h; Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”; VKM-së nr.75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”; Udhëzimit të Përbashkët të MAS dhe MFE nr.20, datë 20.09.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, VKM Nr.243, datë 20.4.2023 “Për një ndryshim në vendimin nr. 748, datë 11.6.2009 ”Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar; Senati Akademik, në mbledhjen e tij të datës 13.07.2023, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Administrats e USH-së,

Vendosi:

1. Miratimin paraprak të pagave të personelit akademik të USH-së, në kufirin maksimal të tyre sipas Lidhjes nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë” të VKM-së Nr.243, datë 20.4.2023 “Për një ndryshim në VKM nr. 748, datë 11.6.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar, pika 7 (materiali bashkangjitur).
2. Burimi i financimit mbi kufirin minimal deri në kufirin maksimal të përballohet nga të ardhurat që realizon USH.
3. Ky vendim i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, por i shtrin efektet financiare prej datës 1 prill 2023.

KRYETARI

Prof. Dr. Raimonda KËÇIRA



Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik, në institucionet Publike të Arsimit të Lartë

Nr. Rendor	Pozicioni/kategoria	Paga	
		Kufiri minimal	Kufiri maksimal
	1	2	3
1	Rektor (Titullar i institucionit) me titullin "Profesor".	179 400	208 910
2	Zëvendësrektor me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	169 800	197 600
3	Zëvendësrektor me gradën shkencore "Doktor (PHD)".	167 520	195 000
4	Dekan me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	169 800	197 600
5	Zëvendësdekan me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	155 400	180 960
6	Zëvendësdekan nga kategoria "Lektorë".	137 040	159 510
7	Përgjegjës i njësisë bazë me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	159 000	185 120
8	Përgjegjës i njësisë bazë nga kategoria "Lektorë".	137 040	159 510
9	Titullar i grupit mësimor/ kërkimor me titujt "Profesor" apo "Profesor i Asociuar".	159 000	185 120
10	Titullar i grupit mësimor/ kërkimor nga kategoria "Lektorë".	137 040	159 510
11	Profesor.	155 400	180 960
12	Profesor i Asociuar.	135 000	157 300
13	Lektorë.	116 040	135 005
14	Asistent Lektorë.	94 200	109 720